



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Përgjithshëm**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. Prot.**  
**Nr. Dok. 201701629/2**

**Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2017**

**Lënda:** *Rekomandojmë rishqyrtimin e dosjes së pensionit të pleqërisë dhe rillogaritjen e masës së pensionit të shtetasit J.P.*

**Drejtuar:** **Drejtorit të Degës Rajonale të Sigurimeve Shoqërore**

**S A R A N D Ë**

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi J.P, në përmbajtjen e së cilës ankohet për masën e ulët të pensionit të pleqërisë dhe kërkon rillogaritjen e pensionit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sipas shpjegimeve të tij, shtetasi J.P, i datëlindjes 07.04.1938, është përfitues i pensionit të pleqërisë që nga data 01.12.1999. Në muajin Prill 1993, në moshën 55 vjeç, me mbylljen e Ndërmarrjeve, ka dalë në pension të parakohshëm, me 60%.

Në kohën që ka dalë në pension të parakohshëm, shprehet më tej ankuesi, ka patur 35 vite e 7 muaj punë. Më datë 01.11.1996 deri më datë 01.11.1999 ka ndërprerë këtë pension dhe është emëruar me detyrë "Drejtor" në Ndërmarrjen Artistike të Sixhadeve, Sarandë. Vjetërsia e përgjithshme e punës shkoi në 38 vjet e 9 muaj. Gjithashtu ka punuar edhe rreth 1 vit e 7 muaj mbi moshën e pensionit të pleqërisë.

Nga ana e Degës Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Sarandë i janë njohur vetëm 31 vite e 10 muaj vjetërsi e përgjithshme e punës.

Ankuesi pretendon se bazuar në vjetërsinë e punës, masa e pensionit që ai gëzon duhet të jetë më e lartë nga sa i është caktuar.

Për t'iu mundësuar rillogaritja e pensionit të pleqërisë, ka kërkuar ndërmjetësimin tonë institucional.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar, ku thuhet se : "*Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*",

### **REKOMANDOJMË:**

*Rishqyrtimin e dosjes së pensionit të pleqërisë dhe rillogaritjen e masës së pensionit të shtetasit J.P.*

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*",

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**